



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilipen/Prigatito Received/Delivered	30 . 11 2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPNSHICK	7147/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1298/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, si procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1298/2023 të datës 17.10.2023 të parashtruar nga ankuesit .

nga Prizreni, te cilet me autorizim i përfaqeson ankuesja Agnesa Thaqi-Kurjeshi kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.11.2023 mori këtë:

V E N D I M

I.HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1298/2023 e datës 17.10.2023 e parashtruar nga ankuesit te cilët me autorizim i përfaqëson ankuesja .

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1298/2023 e datës 17.10.2023 te parashtruar nga ankuesja Sevim Guzhda-Kovaçi të cilën me autorizim e përfaqëson ankuesja Agnesa Thaqi-Kurjeshi.

A r s y e t i m i

Ankuesit (*grup ankuesish*), ..... e punësuar sipas Akt emërimit ,me numër A.E.Nr.01-112/02-0171831 të datës 07.12.2022 e sishemuar nw pozitën e punës "Zyrtare për Energjetike", ..... e punesuar sipas Akt emërimit te datës 04.01.2012 në pozitën e punës "Referente", rari Krasniqi, i punesuar sipas Akt emërimit me numër A.F.Nr.01-112-156301 të datës 03.11.2022 në pozitën e punës "Zyrtar për Infrastrukturë", ..... i punesuar sipas Akt



emermit të datës 04.01.2012 në pozitën e punës "Bashkepuntor Natyror", e punësuar sipas Akt emermit me numër NR.01-112-152942/01 të datës 30.10.2020 në pozitën e punës "Zyrtare Ligjor 2" si dhe e punësuar sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 05.01.2015 mbanë pozitën e punës "Ekspeditues" të gjithë të punësuar në Komunën e Prizrenit. Ankuesit e lartepërmendur më datë 17.10.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim ankimore se me hyrjen e ligjit të pagave në fuqi kemi vërejtur se pagat janë ekzekutuar ndryshe tek zyrtaret të së njëjtës kategori.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 23.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prizrenit. Kjo e fundit, më datë 31.10.2023 i ka përcjellur në Këshill shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesve si në pikën e I të dispozitivit të këtij vendimi është e palejuar, sepse:

Ankuesit më datë 17.10.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 6568/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Prizrenit pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, pagat e tyre ju janë ekzekutuar ndryshe prej zyrtareve të së njëjtës kategori dhe njëjtit kërkojnë që të behet korrigjimi dhe kompensimi i koeficienteve

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve

Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Prizrenit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e



klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, përkatësisht deri me datë 30.09.2023, i cili afat me vendim të Qeverisë së Kosovës Nr.17/162 të datës 27.09.2023 është ndryshuar me që rast Institucionet kanë obligim ligjorë që të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës deri më datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e grup ankuesëve lidhur me kategorizimin e pozitës së tyre është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme edhe në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin të Kosovës, është *jo kompetent* për të vendosur për ankesën e ankueses \_\_\_\_\_ r nga ankuesja \_\_\_\_\_ si në pikën e II të dispozitivit të këtij vendimi, *sepse*:

Ankuesja Sevim Guzhda Kovaçi e punësuar sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 05.01.2015 në pozitën e punës "*Ekspeditues*" të cilës po ashtu me Vendimin e datës 01.07.2022 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i është njohur statusi i nëpunësit administrativ dhe mbështetës. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se këto pozita në bazë të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i aplikueshëm nga data 26.09.2023 përkatesisht nenit 5 paragrafi 5 hyjnë në kategorinë e nëpunësve administrative teknik dhe mbështetës ku përcaktohet se, "*Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike*" dhe si rrjedhojë ankuesja si në pikën II të dispozitivit nuk e ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi.

Duke u bazuar në nenin 95 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, marrëdhënia e punës së nëpunësit *teknik dhe mbështetës* i nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, nëpunësit *teknik dhe mbështetës*, fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.,

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në at që u tha më lartë, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit,



sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lind e drejta e kundërshtimit dhe ankimimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1298/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqesuesit të ankuesve
- Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

